



VENDIM
Nr. 7, datë 28.1.2015

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË RREGULLOREN “PËR
VEPRIMTARINË VALUTORE”

Në bazë dhe për zbatim të shkronjës “c” të nenit 43 dhe shkronjave “d” dhe “dh” të pikës 3 të nenit 60 të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

Në rregulloren “Për veprimtarinë valutore”, miratuar me vendimin nr.70, datë 30.09.2009 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Përmbajtja e nenit 4, ndryshon si më poshtë vijon:

“Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar ose përdorur në:

a) nenin 4 të ligjit nr. 9662, datë 23.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

b) ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar;

c) ligjin nr. 9879, datë 21.2.2008 “Për titujt”,

d) ligjin nr. 7764, datë 2.11.1993 “Për investimet e huaja”, i ndryshuar;

e) Ligjin nr. 52, datë 22.5.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, i ndryshuar.

2. Përmbajtja e nenit 9, ndryshon si më poshtë vijon:

- Shfuqizohet pika “iv” shkronja “a”, paragrafi 3,

- Shfuqizohet pika “i” shkronja “b”, paragrafi 4,

- Paragrafi 4, shkronja “h” ndryshon si vijon, cit:

“h. për transferimin e kapitalit brenda shumës së kapitalit dhe të të ardhurave që rezultojnë nga shitjet, nga likuidimi i pjesshëm ose i plotë i një investimi, kërkohet si dokumentacion shtesë edhe akti i shitjes ose akti i likuidimit nga organi kompetent.”.

3. Përmbajtja e nenit 14, paragrafi 1, ndryshon si më poshtë vijon:

“1. Dokumentacioni i kërkuar në këtë rregullore dhe në

shtojcën nr. 1, të saj paraqitet tek subjekti i licencuar nga Banka e Shqipërisë në origjinal, ose në fotokopje të noterizuar nga origjinali. Verifikimi i dokumentacionit kryhet nga subjekti i licencuar i cili bën fotokopjen e dokumentit të paraqitur dhe vendos një vulë të posaçme (datë) mbi secilën nga fletët e fotokopjuara, e cila i jep vlefshmërinë e dubur kopjes së dokumentit të mbajtur nga subjekti.”.

4. Përmbajtja e shtojcës nr.1, (pjesa I), ndryshon si më poshtë vijon:

“I) Transfertat për veprimet tregtare me mallrat.

1. Për transfertat tregtare me mallra, subjektet e licencuara kërkojnë nga klientët e tyre, paraqitjen e dokumentacionit të mëposhtëm:

a) kërkesa për kryerjen e veprimit e nënshkruar nga vetë kërkuuesi ku pasqyrohet natyra e veprimit dhe qëllimi për të cilin kryhet ky veprim. Në këtë kërkesë, subjekti deklaron se dokumentacioni i paraqitur nuk është përdorur më parë për të justifikuar kryerjen e transfertave të tjera për të njëjtin mall dhe vlerë;

b) fatura pro-forma dhe/ose kontrata ku përvaktohet dhe forma e pagesës.

5. Shfuqizohet shkronja “b” e paragrafit 3.

6. Përmbajtja e shtojcës nr.1, (pjesa II), shkronja “a” ndryshon si më poshtë vijon:

“a) kërkesën sipas paragrafit 1, shkronja “a” (pjesa I) të kësaj shtojce;”

7. Përmbajtja e shtojcës nr.1, (pjesa III), shkronja “a” ndryshon si më poshtë vijon:

“a) kërkesën sipas paragrafit 1, shkronja “a” (pjesa I) të kësaj shtojce;”

8. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes të Bankës së Shqipërisë për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

9. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARI
Elisabeta Gjoni

